



SPAK
NE SYTE E MEDIAS

RAPORT I NDËRMJETËM

MBI MONITORIMIN E RAPORTIMIT MEDIATIK TË VEPRIMTARISË SË SPAK DHE BKH



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Vlerësime të përgjithshme

Monitorimi mediatic është kryer në pesë televizione që shikohen në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Tv Top Channel, Tv Klan, TVSH, Tv News 24 dhe A2 CNN, që përfaqësojnë tipologji të ndryshme

- Sa i përket përcjelljes së informacionit; tre janë televizione gjeneralistë dhe dy janë televizione informative (pra përcjellin informacion 24/7).
- Sa i përket shtrirjes gjeografikë të mbulimit me sinjal të territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Sa i përket pronësisë, katër janë private dhe njëri është publik.

Monitorohen vetëm edicionet qendrore të lajmeve. Edicionet e tjera janë përsëritje (me fare pak freskime) të lajmeve që transmetohen në këtë edicion.

Një rrethanë tjetër që na orjentoj drejt monitorimit vetëm të edicionit qendror ishte edhe natyra e dy televizioneve informative 24/7.

Këto të fundit transmetojnë lajme gjatë gjithë kohës dhe në dy formate të ndryshme; edhe me kronika, edhe me titra

Mbi metodologjinë

Në hartimin e metodologjisë së dorëzuar para fillimit të monitorimit është synuar të arrihen këto rezultate!

a- Të krijohet një bazë të dhënash për numrin dhe një listë e titujve të lajmeve që raportohen mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH

b- Të shikohet se cili është raporti (në kohë) mes lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH dhe gjithë lajmeve të tjera në edicionet qendrore të lajmeve.

c- Të monitorohet rëndësia që redaksia e informacionit i kushton lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH, pra çfarë vendi kanë këto lajme në axhendën e secilës prej redaksive të monitoruara.

d- Të verifikohet se cili është burimi i informacioni mbi këto struktura. Nëse burimi është zyrtar apo informacioneve mbi SPAK dhe BKH gazetarët u qasen nëpërmjet rrugëve të tërthorta siç janë subjektet e hetuara apo ata që vuajnë pasojat e këtyre hetimeve. Nëse informacioni transmetohet bazuar nga pikëvështrimi institucional apo human

e- Të shikohet nëse televizionet në pasqyrimin e lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH kanë të njëjtin qëndrim që kanë edhe ndaj strukturave të tjera të qeverisë, apo ky qëndrim ecën në drejtim të kundërt me qëndrimin që mbajnë ndaj veprimtarisë së qeverisë.

Qëllimi i imonitorimit është të vëzhgojë veprimtarinë e SPAK dhe BKH, por jo duke analizuar statistakisht dhe duke analizuar punën e saj konkrete (studim nisur nga brenda objektit), por duke e parë këtë veprimtari duke u nisur nga lajmet që raportojnë mbi aktivitetin e saj (studim, duke e vëzhguar objektin nga jashtë tij)

Gjetje të përgjithshme

Nga monitorimi i lajmeve që janë raportuar mbi dy strukturat shumë të rëndësishme që janë ngritur për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivelet e larta, vihen re këto përfundime:

Media raporton vetëm lajmet “breaking news” të cilat janë seanca gjyqësore, ose njoftime për median mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH të publikuara në faqen zyrtare të SPAK (<https://spak.al>). Këto janë lajme me bazë Marrdhëniet Publike.

Mungojnë, ose janë fare pak (në këtë periudhë monitorimit, janë më pak se 5) lajmet që kanë karakter shpjegues, analizues e ca më pak investigues mbi veprimtarinë e këtyre dy strukturave. Përshembull, ende nuk e kemi të qartë se pse procesi i funksionimit të BKH ka qenë kaq i ngadaltë. Ose pse procesi që nisi me rekrutimin e kandidatëve të kësaj strukturë rrudhi shumë në numër kandidatët që arritën në fazën e fundit, etj.

Mungojnë lajmet që shpjegojnë ose sqarojnë ndryshimet ligjore që kanë ndodhur për të vënë në funksion këto dy struktura, si dhe ndryshimet ligjore që ndriçojnë raportin e qytetarit me këto struktura. Përshembull, a mundet dhe në cilat rrethana një qytetar ka të drejtë të denoncojë në SPAK ose BKH. Cilat janë të drejtat e tij dhe detyrimet e këtyre strukturave në lidhje me ecurinë dhe transparencën e denoncimeve.

Gjatë periudhës së monitorimit (e cila përkon me pragun si dhe fillimin e fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit) vihen re lajme me karakter politik që nuk kanë si burim SPAK ose BKH por palë të caktuara politike që përmendin

këto dy struktura. Ndërkohë që nga ana e SPAK dhe BKH nuk ka asnjë reagim, qoftë edhe raportues ose informues për të informuar publikun, nëse “denoncimet” janë depozituar zyrtarisht në këto institucione dhe cili është qëndrimi ndaj tyre. (Po shqyrtohen, po hetohet, po analizohet). Kjo praktikë pune e partive politike nga njëra anë dhe kjo sjellje nga ana tjetër e SPAK e BKH, do të ndikojë dukshëm në besueshmërinë e këtyre institucioneve.

Në përgjithësi media raporton objektivisht e në mënyrë korrekte lajmet mbi veprimtarinë e SPAK. Në lajme nuk ka qendrime të hapura e as të fshehura që tregojnë pozicionim të medias ndaj këtyre dy strukturave. Ndërkohë që kur raportohen lajme të aktorëve dhe faktorëve politikë, të cilët kërkojnë të përfshijnë SPAK dhe BKH nuk konstatohet i njëjti qëndrim i medias ndaj SPAK e BKH

Në media konstatohet sindroma e harresës. Pra, lajmet që raportohen, nuk ndiqen nga gazetarët për të mësuar rreth “fatit”, përfundimit të tyre.

Për të vendosur studimin në një kontekst më të gjerë kam vëzhguar faqen zyrtare të SPAK, veçanërisht rubrikën e medias. Nga një vëzhgim i sipërfaqshëm konstatoj se administrimi i faqes nuk ka kujdesin e nevojshëm.

Sa i përket dizajnit, të gjitha njoftimet për shtyp shoqërohen me të njëjtën foto.

Sa i përket strukturës, konstatoj se në rubrikën që titullohet “Media” përveç lajmeve gjen edhe vendime, urdhëra, udhëzime apo njoftime me karakter administrativ. Këto informacione mund të jenë interesante, por mendoj që mund të vendosen në një rubrikë tjetër.

Gjetje të veçanta

Thuajse të gjitha televizionet e monitoruara raportojnë lajme mbi veprimtarinë e SPAK, BKH madje edhe të Gjykatës së Posaçme, e cila jep vendimin ndaj hetimet që ka kryer SPAK dhe BKH.

Lajmet proporcionalisht kanë të njëjtën gjatësi kohore dhe afërsisht të njëjtin pozicion në edicionet qëndrore të televizioneve.

Televizioni Top Channel nuk ka raportuar lajme mbi denoncimet që Partia Demokratike ka kryer ndaj strukturave shtetërore ose atyre të mazhorancës qeverisëse.

Dhe e kundërta Tv Klan, nuk ka raportuar mbi disa denoncime që mazhoranca i ka bërë në SPAK për përfaqësues të Partisë Demokratike.

Ndërsa TVSH nuk raporton asnjërën e as tjetrën.

Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, Deputetit, Zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Në më shumë se 568 çështje të referuara dhe me më shumë se 700 persona në hetim, duket se deri më tani, SPAK ka hetuar apo ka në hetim një numër shumë të ulët të zyrtarëve të lartë. Sipas të dhënave të administruara nga burimet zyrtare të SPAK, rezulton se gjatë periudhës së monitorimit hetimi i zyrtarëve të lartë paraqitet në këtë situatë:

Televizioni	Lajmi	Data
Klan	Protestat, PD padit Drejtorine e Përgjithshëm të Policisë	14 Dhjetor 2020
Klan	Mbyllet hetimet per dosjen 184 Reagimi I PD per vendimin e prokurorise	18 Dhjetor 2020
News24	Aleanca për Teatrin padit Veliain në SPAK	5 Janar 2020
A2 CNN News24 Klan	PD padit në SPAK Ramën, ministra, kryebashkiakë e deputetë	6 Janar 2021
Klan	Nis zgjyqi per zgjedhjet e Dibres. Avokati I PD, kerkon hetimin nga SPAK	15 Janar 2021
Klan	Velija paralajmeron padi per Dumen per shpifje PD: Rame e Veliaj te lidhur me NDRAGETAN.	21 Janar 2021
A2 CNN News24	Spak merr në pyetje Olta Xhacckën; Tenderi për materialet anti-covid në ushtri & blerje ushqimesh	23 Janar 2021
Klan	PD denoncon në SPAK Ballukun për portin e Durrës	5 Mars 2021

E kundërta ndodh me televizionin Top Channel, I cili ka raportuar lajmet e mëposhtme që kanë një kontekst politik.

Televizioni	Lajmi	Data
Top Chanel	SPAK nis hetimin e dosjes Partizani	16 Dhjetor 2020
Top Chanel	Si u zhvat Kompleksi Partizani	16 Dhjetor 2020
Top Chanel	PD-LSI do ndryshojnë reformën	2 Mars 2021
Top Chanel	Nga Gërdeci padi për Mediun në SPAKN	15 Mars 2021
Top Chanel	SPAK hetim Mediut për Gërdecin	17 Mars 2021

Një bazë të të dhënave mbi listën e plotë të lajmeve që janë raportuar në televizionet e monitoruara, kohëzgjatjen e secilit prej lajmeve, renditjen e të dhënave të tjera përmbajtësore do t'i gjeni pas analizës së tabelave në exel.

Rekomandime

Të përmirësohet si në imazh, është edhe në strukturë faqja zyrtare e SPAK.

Të ketë një reagim ndaj lajmeve me karakter politik që publikohen në media

Media të respektojë standardet bazë që kërkon raportimi i informacionit, sidomos lajmet që burojnë nga politika. Sepse, në të kundërt duket sikur politika përdor median për qëllimet e saj të luftës politike.

Media të përfshijë në axhendën e saj edhe lajme me karakter shpjegues analizues për të informuar publikun për këto dy struktura shumë të rëndësishme.

Media të ushtrojë atë që quhet “ndjekje/vazhdimësi” e lajmit. Në këtë mënyrë media do të ushtrojë “presionin” e duhet dhe të nevojshëm mbi këto struktura, por njëkohësisht do të mbajë të informuar publikun për informacione që ajo vetë ka raportuar.